

## DEMOKRACIA

---

PËRFAQËSIMI DHE PJESEMARRJA

PLURALIZMI

DEMOKRATIZIMI

---

>> Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. Gjithkush ka të drejtë të barabartë për qasje në shërbimet publike në vendin e tij. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës ekuivalente të votimit të lirë. <<

### NENI 21. DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT.

#### TREGIM ILUSTRUES

##### **Ndërtimi i demokracisë në Timorin Lindor.**

Në vitin 1999 pas mëse 450 vjet okupimesh të huaja dhe 25 vjet okupimi nga Indonezia, timorezët lindorë votuan për pavarësi në një referendum popullor të organizuar nga Kombet e Bashkuara. Thirrja për pavarësi nga Indonezia u përcoll menjëherë me valë të dhunës. Të mbështetur nga Forcat e Armatosura të Indonezisë, grupet e milicias pro-indoneziane u përgjigjën duke vrarë së paku 1000 persona dhe duke deportuar qindra mijëra të tjerë në Timorin Indonezian Përendimor. Qytete dhe fshatra u shkatërruan nga këto trupa.

Si përgjigje për krizën, Kombet e Bashkuara dërguan tupa më 20 shtator 1999 dhe krijuan Administratën e Përkohshme të Timorit Lindor (APTLKB) me 26 tetor.

Me ndihmën e Kombeve të Bashkuara, Republika Demokratike e Timorit Lindor zyrtarisht filloi të ekzistojë më 20 maj 2002. Një asamble e konstituar prej 88 anëtarësh u zgjodh më 30 gusht 2001, në zgjedhjet e para demokratike në Timorin Lindor.

*Asambleja shkruajti kushtetutën e vendit, e cila krijoi një republikë demokratike me parlament, kryeministër dhe president ceremonial.*

*Zgjedhjet e para presidenciale u mbajtën me 14 prill 2002. Fitues ishte Xanana Gusamo, një ish-lider i gueriles së luftës për pavarësi. Gusamo ishte një legjendë në mes njerëzve dhe shpresohet se popullaritetit i tij do të ndihmojë që të stabilizohet vendi. APTLKB u ndërrua nga Misioni i Kombeve të Bashkuara për Mbështetje të Timorit Lindor (MKBMTL), i cili mbeti në vend deri në maj të vitit 2003. Me 5000 trupat e tij dhe 1250 zyrtarët e policisë, MKBMTL ndihmonte qeverinë që të ofrojë siguri për qytetarët e tij gjatë vitit të parë të ekzistencës.*

*Më 27 shtator 2002 Timori Lindor u bë anëtar i 191-të i Kombeve të Bashkuara.*

### **Drejtësia dhe pajtimi**

*Tranzicioni i Timorit Lindor në demokraci ka qenë i megjulluar nga fakti se shumica e njerëzve që kishin bërë krime në vitin 1999 nuk kishin dhënë llogari për krimet e tyre.*

*Shumica e autorëve të krimve jetonin në Indonezi dhe qeveria refuzonte që t'i ekstradojë të dyshuarit tek autoritetet e Timorit Lindor.*

*Me iniciativat dhe rekomandimet e bashkësisë ndërkombëtare, qeveria Indoneziane krijoi një tribunal të të drejtave të njeriut në Xhakartw për t'i persekutuar krimet kundër njerëzimit të kryera në vitin 1999. Tribunali ishte krijuar që t'i gjykojë zyrtarët qeveritarë dhe anëtarët e forcave të sigurimit.*

*Shumë nga monitoruesit e kanë kritikuar dështimin e tribunalit që të akzujw të dyshuarin kryesor, Gjeneralin Uiranto, shefin e forcave të armatosura Indoneziane gjatë kohës së masakrave. Përveç kësaj, zyrtarët të cilët ishin gjykuar, ose ishin shfajësuar ose kishin marrë dënime të lehta.*

*Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut dhe grupet e tjera të të drejtave të njeriut si Amnesty International apo Human Rights Watch kanë sjellë prova se gjykimet ishin thellë të kurdisura, që nga fillimi i tyre.*

*Avokatët e të drejtave të njeriut kanë argumentuar se tribunali ndërkombëtar i sponsoruar nga KB duhej të krijohet për Timorin Lindor njësoj, siç është krijuar për krimet e kryera në ish-Jugosllavi apo Ruandë.*

*Liderët e Timorit Lindor, megjithatë, janë të ndarë nga fati i anëtarëve të milicisë të cilët kishin kryer krimet.*

*Në një përpjekje që të promovojë shpirtin e unionit nacional dhe pajtimit, presidenti Guasmo ka thënë se ata që janë akuzuar për dhunë duhet të amnistohen. Megjithatë, kryeministri Mari Alkatit argumenton se drejtësia duhet çuar në vend.*

### **Më shumë sfida në të ardhmen**

*Qeveria duhet po ashtu të përballë me sfidën për riatdhesimin e mijëra refugjatëve.*

*Më shumë se 250 000 timorezë lindor kishin ikur në Timorin Përendimor pas votimit të pavarësisë në vitin 1999, shumica nën kërcënimin e forcës. Edhe pse shumica janë kthyer në Timorin Lindor në muajt e tashëm, është llogaritur se 30 000 timorezë lindorë ende jetojnë në kampet e refugjatëve në Indonezi.*

*KB ka deklaruar se çdo refugjati i cili mbetet në Timorin Përendimor deri në fund të vitit 2002 do të konsiderohet si qytetar indonezian.*

*Shumë sfida gjenden përpara të kombit të ri, përfshirë këtu edhe mënyrën se si të sillen me kryesit e krimeve, qindra mijëra refugjatë dhe varfërinë, dhe kuptohet, detyrën që të kujden për strukturat demokratike të reja.*

### **BURIMI:**

ADAPTUAR NGA: BBC WORLD SERVICES, NË DISPOZICION NË  
[HTTP://WWW.BBC.CO.UK/WORLDSERVICE/PEOPLE/FEATURES/IHAVEARIGHTTO/INDEX.SHTML](http://www.bbc.co.uk/worldservice/people/features/ihavearightto/index.shtml).

## **PYETJE PËR DISKUTIM**

1. A njeh ndonjë shtet që lufton për demokraci? Cilat janë problemet me të cilat përballen ato?
2. Cilët janë elementet kryesore që duhet t'i parashohë dhe për të cilët duhet të përkujdeset procesi i demokratizimit?
3. Si mund të zgjidhen në mënyrë demokratike sfidat me të cilat përballen administrata e re në Timorin Lindor?
4. Si mund të kontribuojnë qytetarët aktivë në procesin e demokratizimit në vendet e tyre? Mundohu të japësh sygjerime konkrete!

## **E DOMOSDOSHME TË DIHET!?**

### **1. DEMOKRACIA NË RRITJE?**

E drejta për pjesëmarrje është në zemër të të drejtës njerëzore, dhe është themel i parimeve, vizioneve dhe vlerave të reflektuara nga Rrjeti i Sigurisë Njerëzore. Agjenda speciale e politikave, e ndjekur nga vendet anëtare, për përparimin e sigurisë njerëzore, mbështetet në pjesëmarrje dhe demokraci.

Demokracia zakonisht shpjegohet si sundim i popullit. Megjithatë, demokracia është shumë e vështirë që të definohet – është formë e qeverisë, por po ashtu është ide e cila thekson organizimin sociopolitik dhe juridik të shtetit, dhe të mund të shihet edhe si ideologji, mund të shfaqet si formë e modeleve të ndryshme në realitet dhe në teorinë shkencore – së bashku është një shenjë të kutpimeve të ndryshme dhe të panumërta.

Demokracia është e ndërlidhur fuqishëm me parimet e të drejtave të njeriut dhe nuk mund të funksionojw pa garantimin e respektimit të plotë dhe pa mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Është një lidhje e qartë në mes strukturave jodemokratike dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Deri më tani demokracia është pakontestueshëm sistemi më i përçueshëm për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore.

<b>PROGRESI DEMOKRATIK GLOBAL</b>	<b>NDARJA GLOBALE</b>
Që nga viti 1980, 81 shtete kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt demokracisë, me ndërrimin e 33 regjimeve ushtarake me qeveri civile.	Nga 81 demokracitë e reja, vetëm 47 janë plotësisht demokratike. Shumë të tjera nuk shihen se janë në tranzicion drejt demokraci apo janë kthyer përsëri në autoritarizëm ose konflikt.
140 nga 200 shtetet e botës sot mbajnë zgjedhje shumëpartiake – më shumë se kurdoherë në histori	Vetëm 82 shtet me 57 % të popullatës botërore janë plotësisht demokratike
125 shtete me 62% të popullatës botërore kanë shtyp të lirë apo pjesërisht të lirë	61 shtete me 38% të popullatës botërore ende nuk kanë shtyp të lirë
Numri i shteteve që kanë ratifikuar gjashtë konventat e të drejtave të njeriut dhe konventat është rritur në mënyrë të shpejtë që nga viti 1990. Ratifikimi i KNDKP dhe KNDESK është rritur nga 90 në afërsisht 150 shtete.	106 shtete ende ndalojnë liritë të rëndësishme civile dhe politike.
38 shtete nuk kanë ratifikuar apo nënshkruar KNDKP, dhe 41 nuk e kanë ratifikuar apo nënshkruar KNDESK	Në të gjithë botën 14% e parlamentatëve janë femra – dhe në 10 vende nuk është asnjë femër.
Në 10 vende më shumë se 30% e	

parlamentarëve janë femra	
---------------------------	--

## **BURIMI:**

UNDP, RAPORTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR, 2002.

Demokracia varet nga interesi dhe pjesëmarrja aktive e përfituesve të saj. Duke qenë i informuar dhe duke pasur qasje në njohuritë, si parakusht për pjesëmarrje të kuptimtë në sistemin demokratik. Vetëm ata që kanë një kuptim themelor se si punon sistemi, dhe dijeninë e mekanizmave dhe institucioneve në një shoqëri demokratike mund të kontribuojnë dhe të përfitojnë. Kujtimi i kësaj porositje është njëra nga funksionet më të rëndësishme të edukimit mbi demokracinë, qëllimi i të cilave është krijimi i qytetarëve të përgjegjshëm.

Ky modul ka për qëllim skicimin e një pasqyre të demokracisë dhe të drejtave të njeriut e cila e bën të qartë se demokracia nuk është gjë që arrihet njëherë e përgjithmonë, por është një proces që kërkon punë të përhershme dhe përkushtim.

### **Demokracia dhe siguria njerëzore.**

Agjenda e sigurisë njerëzore fokusohet në mbrojtjen e lirisë nga kërcënimet që përhapen për jetët e njerëzve dhe mjeteve të jetesës, politike, sociale apo ekonomike, dhe fillon me idenë se respekti për të drejtat e njeriut dhe liritë demokratike si dhe fuqizimin e zhvillimit njerëzor janë të domosdoshëm për mbrojtje dhe promovim të sigurisë njerëzore. Përparimi i të drejtave njerëzore, zhvillimit njerëzor dhe sigurisë njerëzore – koncepte të ndërlidhura dhe që plotësojnë njëra-tjetrën të cilët janë bërthama e vizionit për një rend botëror të përzirer – me të vërtetë mund të zënë rrënjë vetëm në shoqëri ku vlerat demokratike janë jo vetëm të propoganduara por edhe të praktikuara.

Vetëm në demokraci, respekti për të drejtat e njeriut nënkupton lirinë nga frika dhe nga kërcënimet për ekzistencën themelore të tyre: zhvillimi njerëzor kërkon kërkesë për burimet dhe liritë të cilat duhen që të zhvillohet plotësisht potenciali njerëzor: siguria njerëzore përfshin lirinë nga uria, lufta, katastrofës ekologjike, qeverisë së korruptuar dhe

kërcënimeve të tjera ndaj jetës së jetuar në drejtësi, solidaritet, me barazi dhe shans për të gjithë.

Ta përmbledhim të tjerë - vetëm me pjesëmarrje demokratike të barabartë, të lirë në jetën sociale dhe ekonomike të shtetit apo bashkësisë mund shtyjë sigurinë njerëzore. Vetëm garantimi i plotë i të drejtave të njeriut, qeverisë pjesëmarrëse, dhe qasje të barabartë në burime mund të garantojnë sigurinë njerëzore të kthyer nga një model i ri diplomatik në bazat e gjera të vendimmarrjes demokratike dhe kooperimit ndërkombëtar.

## 2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI

### **Çka është demokracia dhe si është zhvilluar !?**

Demokracia është një formë e qeverisjes me të cilën autoriteti shtetëror rrjedh nga populli. Fjala “demokraci” vjen nga fjala e vjetër greke demos- që do të thotë njerëz dhe kratos që do të thotë fuqia. Parimet e demokracisë moderne janë zhvilluar gradualisht nga lëvizjet religjioze të kalvinizmit gjatë shekullit 17 veçanërisht në Skoci, Angli dhe Holandë ku bashkësitë filluan të mbështesin dhe të ndajnë jo vetëm idetë religjioze, por edhe ato politike. Filozofia e lirisë dhe barazisë u shtua edhe më tej gjatë periudhës së iluminizmit që pastaj do të njihen si vlerat thelbësore të demokracisë.

Shteti i parë demokratik ishte themeluar në SHBA, kure Franca ishte shteti i parë evropian i themeluar me parime demokratike, pas revolucionit francez.

Pas vitit 1945 kishte një përhapje të demokracisë perëndimore në Evropë dhe nëpër botë, e cila zëvendësoi format autoritare të qeverisjes. Pas mundjes së qeverive fashiste, dukej se kriza të cilën e përjetoj demokracia gjatë shekullit 20 u tejkalua. Procesi i gjatë i dekolonizimit në të cilin e drejta për vetëvendosje u njoh nga vendet perëndimore rezultoi me sjelljen e demokracisë në ish kolonitë e tyre. Diktaturat në Spanjë, Portugali, Greqi, Argjentinë dhe Uruguaj, të gjitha u bënë demokraci në dekadat e fundit. Me rrëzimin e murit të Berlinit në vitin 1989 dhe kolapsin e sistemit stalinist në Evropën Qendrore dhe Lindore, u pa se demokracia me të vërtetë ka triumfuar. Megjithatë, jo të gjitha vendet të cilat teorikisht përkrahin demokracinë si një formë të qeverisjes nuk i respektojnë parimet demokratike apo jetën e praktikës demokratike. Ky më tepër si një zhvillim paradoksal,

demonstron se mbajtja e debatit kritik mbi demokracinë dhe demokratizimin është një nevojë.

>> *Nocioni im i demokracisë është se më i dobëti duhet të ketë shansin e njëjtë sikurse më i forti.<<*

## MAHATMA GANDI

### Elementet thelbësore të demokracisë moderne

Është vështirë të matet se si është shoqëria demokratike. Megjithatë, është një numër i elementeve kyçe të cilat konstituojnë bazat e çdo shoqërie demokratike. Për të kuptuar më mirë këto elemente, arsimimi dhe mësimi në të gjitha nivelet luajnë një rol kyç.

- **Barazia** – parimi i barazisë nënkupton se të gjitha qeniet njerëzore janë të lindura të barabartë, duhet të gëzojnë mundësi të barabarta, pjesëmarrje në jetën politike të bashkësisë si dhe titullim i trajtimit të barabartë përballë ligjit. Kjo përfshin po ashtu barazinë sociale dhe ekonomike në mes femrave dhe meshkujve.
- **Pjesëmarrja** – demokracia është e pakuptimtë pa pjesëmarrje, pjesëmarrja në bashkësi dhe çështjet e politikave është një parakusht i ndërtimit të sistemit demokratik. Demokracia është një formë e pjesëmarrjes, ndonjëherë pjesëmarrja është një koncept i gjerë dhe nuk përmban vetëm nënkuptime të fuqishme politike, por, po ashtu, ato sociale dhe ekonomike. Por pjesëmarrja vetëm nuk mund të garantojë demokracinë.
- **Sundimi i shumicës dhe të drejtat e pakicës**- edhe pse demokracia është nga definicioni sundimi nga populli, në fakt është sundimi i shumicës. Kjo po ashtu nënkupton një obligim të shumicë që të marrë parasysh të drejtat dhe nevojat e ndryshme të grupeve të pakicave. Shkalla në të cilën obligimet janë plotësuar janë një indikator i shtimit të mëtutjeshëm i vlerave demokratike në shoqëri.

Moduli i diskriminimit

- **Sundimi i ligjit dhe gjykimi i paanshëm** – demokracia nënkupton mbrojtje të një personi apo grupi të vogël nga sundimi arbitrar. Sundimi i ligjit siguron barazi përpara ligjit, kufizimi të fuqisë apo autoritetit publik dhe ofrimi i qasjes së barabartë në juridiksion të pavarur dhe të paanshëm

Moduli i gjyqimit të paanshëm dhe sundimit të ligjit
- **Respekti për të drejtat e njeriut**- pranimi se të gjitha qeniet njerëzore janë të lindura të barabarta dhe të lira në dinjitet dhe të drejta është themeli i funksionimit të bashkësisë demokratike. Një shtet demokratik ka për obligim sigurimin që të sigurojë dhe të respektojë, të mbrojë dhe të përmbush të gjitha të drejtat e njeriut në mënyrë që të sigurojë se të gjithë qytetarët e tij mund të jetojnë të lirë nga frika dhe të lira nga kërkesa. Lidhur me demokracinë, një përqendrim special duhet të shtrihet në ato të drejta të cilat janë kyçe për pjesëmarrje civile, siç është e drejta për grumbullim, liria e të shprehurit, liria e të menduarit, ndërgjegjes dhe religjionit. Ende, të drejtat civile dhe politike nuk mund të garantojnë paqe dhe siguri njerëzore. Një ambient i favorshëm për demokracinë mund të krijohet vetëm nëse merren parasysh nevojat themelore ekonomike, sociale dhe kulturore.
- **Pluralizmi politik** - tradicionalisht, është detyrë e partive politike që të konsolidojnë diversitetin e ideve dhe opinioneve dhe t'i përfaqësojnë ato në debatin publik. Vetëm pluralizmi politik mund të sigurojë struktura mjaft fleksibile që të përshtat nevojat e ndryshme, por ende mbetet bazë për qeverisje demokratike. Megjithatë, liritë politike mund të keqpërdoren për përhapjen e ideve që nxisin urrejtje, provokojë dhunë dhe pastaj shkaktojnë kërcënim për rendin shoqëror demokratik. Në fakt është shumë vështirë t'u bëhet ballë tendencave të tilla në mënyrë demokratike pa nëpërkëmbjen e lirisë së të shprehurit, por po ashtu duke mbrojtur interesin e shoqërisë në përgjithësi. Në masë të caktuar, demokracive u duhet ta mbrojnë vetveten, p.sh. kundër terrorizmit.

- **Zgjedhje të lira dhe paanshme-** zgjedhjet janë karakteristika më themelore e demokracisë. Asnjë lloj i regjimit tjetër nuk lejon vendimin mbi udhëheqjen politike për ata të cilët janë të influencuar nga sistemi qeverisës - populli. Në çdo zgjedhje, ata mund të shprehin dëshirat e tyre për ndryshim si dhe pëlqimi i tyre për politikën e tanishme dhe pjesëmarrjen e vazhdueshme të procesit të evaluimit. Megjithatë, historia ka treguar se nuk është mjaft e vështirë të kërkesat e pjesëmarrjes e kush nuk e ka. Për shembull femrat ishin të përjashtuara nga sistemi për një kohë të gjatë. Në Angli dhe Zvicër, vend mjaft i njohur për strukturën e lartë demokratike, ato e morën të drejtën votuese në fillim të vitit 1999. Është element i domosdoshëm të sigurohet që e drejta e votës të jetë universale, e lirë, e barabartë, sekrete dhe direkte.
- **Ndarja e pushteteve** – ndarja e pushteteve u paraqit si koncepti nga Loku (“Dy traktate për qeverisje”. 1690) dhe u përparua nga Montekje (“ Fryma e ligjeve”, 1748). Në luftën e tyre kundër shtetit absolut, është një parim themelor për demokracinë moderne. Sipas parimit të ndarjes së pushtetit shtetëror në trupat ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore, ato funksionojnë të pavarura, por i japin përgjegjësi njëri-tjetrit dhe popullit. Sistemi i kontrollit dhe balancit ofron një mekanizëm adekuat të kontrollit dhe si i tillë parandalon keqpërdorimin e pushtetit të shtetit.

### **Teoritë e demokracisë**

Kompleksiteti veprues i realitetit demokratik ka prodhuar grupe të mëdha teorish dhe modelesh.

Një dallim në mes të grupeve të teorive do të përmendet, sepse roli i saj është tradicional dhe pavarësisht nga të qenit shumë e thjeshtë në debatin e sotëm ka dallim në mes të identitetit dhe teorisë së konkurrencës të demokracisë. Shkurt, të konsideruarit e demokracisë si konkurrencë, lejon opinione të ndryshme legjitime, të cilat konkurrojnë (me konkurrencën e opinionëve të varguar zakonisht në anën e sundimit të shumicës). Demokracia si identitet e sheh një identitet në mes të sundimit dhe të qenit i sunduar dhe

kundërshton ekzistimin e dallimeve të justifikueshme, por lufton që ta gjejë atë që Ruso e quante *volonte generale* (vullnet i përgjithshëm) dhe që më pas të vihet në legjislacion.

### **Format e demokracisë**

Sot demokracitë dallohen për nga disenji dhe struktura e tyre. Dallimi tradicional ndërmjet demokracive liberale është ai në mes modeleve të demokracisë **direkte dhe të përfaqësimit**.

**Demokracia direkte** është një formë e qeverisjes në të cilën e drejta për të marrë vendime politike ushtrohet direkt nga i gjithë trupi qytetar, duke vepruar nën procedurat e sundimit të shumicës. Kjo formë është e mundshme vetëm për etnitete të vogla. Për këtë arsye asnjë sistem modern demokratik nuk është sistem i pastër demokratik edhe pse të gjithë ata kanë elemente të demokracisë direkte. Institucionet e demokracisë direkte janë asamblatë popullore, iniciativat legjislative popullore, dorëheqjet, referendumi etj.

Forma e dytë është ajo e **demokracisë përfaqësuese**. Kjo është një formë e qeverisjes në të cilën qytetarët ushtrojnë të njëjtën të drejtë, jo personalisht, por nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur nga ata dhe të përgjegjshëm ndaj tyre. Dy elementet më qenësore të demokracisë përfaqësuese janë ndarja në mes të sunduesit dhe të të qenit i sunduar, dhe zgjedhjet periodike se një mjet kontrolli e sundimit nga të sunduarit.

Demokracia përfaqësuese është e ndërlidhur me dy forma themelore të qeverisjes: demokracinë parlamentare dhe presidenciale.

*-Demokracia parlamentare:* në këtë formë demokratike parlamenti ka rol qendror; ekzekutivi udhëhiqet nga kryeministri apo lideri i kabinetit dhe është i varur nga besueshmëria e parlamentit; kryetari i shteti zakonisht ka pak apo nuk ka fare fuqi ekzekutive, por vetëm funksion përfaqësues,

*-Demokracia presidenciale:* ekzekutivi udhëhiqet nga vetë kreu i shtetit i cili zgjidhet direkt nga populli dhe nuk ndërvaret nga besueshmëria e parlamentit.

Kur dy modelet krahasohen, dallimet që dalin në pah përfshijnë:

- Në sistemin presidencial, bëhen zgjedhje të ndara për qeverinë dhe për asamblenë parlamentare, kurse në demokracitë parlamentare një palë zgjedhje vendosin për të dyja (kurse kryetari i shtetit mund të zgjidhet ndaras).
- Në sistemin parlamentar qeveria autorizohet nga parlamenti, i cili mund ta thërrisë të japë dorëheqje. Ky opcion i refuzohet parlamentit në sistemet presidenciale, përveç procedurës së implimentit.
- Në anën tjetër, kreu i shtetit në sistemin parlamentar zakonisht ka mundësi që të shpërndajë asamblenë parlamentare në kushte të veçanta.
- Anëtarësimi në parlament është parakusht për anëtarësim në qeveri në shumë sisteme parlamentare, ndërsa është jokompatibil me shumë sisteme presidenciale.
- Parlamenti dhe qeveria zakonisht janë më shumë të ndërlidhura me demokracitë parlamentare, kurse në sistemet presidenciale ka një ndarje më të qartë të pushtetit. Sidoqoftë, pushteti ekzekutiv është i ndarë shpesh ndërmjet kreut të shtetit në njërin anë dhe kryeministrit, në anën tjetër.
- Iniciativa legjislative në demokracitë parlamentare është shumë e mbështetur me iniciativën e qeverisë.
- Partitë, në veçanti partitë opozitare luajnë një rol shumë të fuqishëm në demokracitë përfaqësuese.

Sot, forma më e zakonshme në mes të të gjitha formave të modeleve të përziera është ajo e demokracisë parlamentare me një rol të shtuar të kreut të shtetit.

### **Format e demokracisë në realitet.**

Shumica e formave ekzistuese të demokracisë janë të kombinuara me këto dy tipe ideale dhe tiparë të elementeve nga të gjitha format.

**Shembujt:** Shembujt klasikë ilustrojnë modelet e poshtëshënuara: demokracia parlamentare si një model që nënkupton sistemin e Britanisë së Madhe dhe shumicës së shteteve përendimore evropiane; dhe në anën tjetër Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë

shembulli më i mirë i demokracisë presidenciale. Edhe në Evropë modelet e veçanta janë shumë të shpeshta: Zvicraa, Franca (demokraci gjysmëpresidenciale), Portugalia. Dallimi, po ashtu, mund të zbatohet në të gjitha demokracitë e tjera përrreth botës, megjithëse ato nuk shfrytëzojnë traditat të cilat vijnë nga liberalizmi.

### **3. PRESPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET KONTRAVERSE**

Demokracia merr forma të ndryshme, ka manifestime të ndryshme dhe kuptohet ndryshe në kultura të ndryshme. Përderisa disa demokraci i japin prioritet ndarjes së pushteteve dhe sundimit të ligjit, të tjerat mund të ndërtohen në mënyrë dominuese përreth konceptit të pjesëmarrjes. Dallimet që dalin janë të bazuara në bashkëveprimin e elementeve thelbësore, përbërëse të demokracisë.

Një vijë e madhe e kritikës në përmbajtje i referohet “eurocentrizmit” i përfshirë në shumë mendimi politike, teori dhe praktika në lidhje me demokracinë.

Nuk ekziston një gjë e tillë si “demokraci e përkryer”, as në hemisferën lindore dhe as në atë perëndimore.

Për një të gjithë mund të pajtohemi – mbi elementet përbërës të demokracisë, por rëndësia e vendosur në këto elemente dhe realizimi i tyre dallon shumë në mes kulturave. Kuptimi perëndimor i demokracisë është i bazuar në nocionin e individit, i cili merr lirinë maksimale dhe zërin në relacion me të tjerët në shoqërinë demokratike. Theksimi i pakalueshëm mbi të drejtat civile dhe politike që ndodhen në këtë model janë problem për disa shtete të tjera.

#### **Debati për “vlerat aziatike”**

Disa modele shoqërore aziatike janë bazuar në konceptet e pjesëmarrjes që pak kanë të bëjnë me demokracinë e kuptuar në perëndim. Ato bazohen në një sens të orientimit të bashkësisë dhe koncepteve tradicionale të udhëheqjes oligarkike më parë se në idenë e

lirisë maksimale për individin. Ky model nuk është domosdoshmërisht i papajtueshëm me pjesëmarrjen në demokraci.

Ai rrjedh nga mësimet e mbështetura në traditën konfuciane, dhe kërkon pjesëmarrje aktive të një elite sunduese morale dhe racionale që vepron për të mirën e përbashkët. E ashtuquajtura përplasje në mes të vlerave dhe nocioneve “aziatike” dhe “perëndimore” të arsyeve demokratike buron nga keqkuptimi i demokracisë dhe pjesëmarrjes. Lideri/filozof i Singaporit Lii Kuan Yeu dhe të tjerët i adresojnë kritikën e tyre kundër rregullit shoqëror dhe kulturor të SHBA dhe të disa vendeve perëndimore më parë sesa të jenë kritikë për vetë demokracinë.

### **Sfidat e demokracisë në shtetet islame**

Përcaktimi i marrdhënieve ndërmjet islamit dhe demokracisë ka qenë problematik për myslimanët dhe jomyslimanët. Monitoruesit perëndimor të cilët kanë pohuar se islami dhe demokracia janë jokompatibile, argumentet e tyre i kanë bazuar në kuptimin islamik të sovranitetit të Zotit, i cila është burimi i vetëm i autoritetit politik dhe nga i cili profetohen se vijnë të gjitha ligjet dhe rregulloret që qeverisin bashkësinë e besimtarëve.

Myslimanët, po ashtu, janë të ndarë rreptësisht në kuptimin dhe qasjen e tyre kundrejt demokracisë. Përderisa liderët e rrymave qendrore të lëvizjeve islamike dhe shumë dijetarë mendojnë që islami dhe demokracia janë kompatible, ekstremistët apo islamistët radikalë propagojnë të kundërtën. Refuzimi i fundit i demokracisë, duke thënë se koncepti i sovranitetit të popullit kundërshton besimin themelor të islamit që mbështetet në sovranitetin e Zotit. Kjo kornizë legislative mund të argumentohet se Allahu nuk mund të modifikohet. Çdonjëri që zbaton ligjet e tij mund të jetë përfaqësuesi i tij. Kjo qasje radikale është kundërshtuar nga vlerat themelore demokratike, siç është të qenit i hapur, pluralizmi dhe ndarja e pushtetit.

Vizioni islamik i demokracisë është manifestuar në *Shura*, një koncept islamik i këshillimit në drejtim të çështjeve të përbashkëta. Këshillimi kërkohet në çështje të ndërlidhura, të cilat ndikojnë në jetën kolektive, ku njerëzit duhet të kenë lirinë e të

shprehurit. Megjithatë, Shura është e kufizuar nga legjislatura e Allahut, duke thënë se pjesëmarrja islamike është edhe një pengesë e demokracisë dhe e kuptimit përendimor.

Moduli i lirisë së religjionit.

## **PYETJE PËR DISKUTIM**

- Pse disa elemente të demokracisë janë më të rëndësishme sesa të tjerat në mesin e kulturave të ndryshme?
- A është e pranueshme që të ketë nocione të ndryshme të demokracisë në kulturat e ndryshme?
- Nëse interpretimet e ndryshme të demokracisë janë të pashmangshme dhe të pranueshme, ku janë kufijtë, p.sh. cilat elemente thelbësore duhet të ruhen nën çdo situatë, në mënyrë që të përceptojmë shtetin përkatës si “demokratik”?
- Cili është roli i mediave në definimin e nocionit të demokracisë në shtetet e ndryshme?

## **Disa pika për mendim të mëtutjeshëm**

- **Marrëdhëniet në mes shumicës dhe pakicës**, dhe në veçanti në mbrojtjen e minoritetit politik, janë çështje qenësore. Parimi demokratik i zgjedhjes mbi bazat e votës së shumicës e cila kështu fiton të drejtën për ushtrimin e votës nënkupton se minoriteti i krijuar shpesh përjashtohet nga vendimarrja politike. Ky minoritet duhet të pajtohet me vendimin e shumicës. Minoritetet prandaj duhet të kenë mbrojtje speciale, në mënyrë që t’u garantohet respektimi i të drejtave të tyre dhe shkalla e përfshirjes në raport me dëshirën e tyre politike.
- **Shoqëria civile**, është bërë njëra nga temat kryesore në debatin e praktikimit të demokracisë. Demokracia ka nevojë për qenie njerëzore të lira dhe aktive, si dhe për njerëz të përgjegjshëm. Berthold Brecht ka sygjerruar njëherë në mënyrë ironike se në qoftë se qeveria është e pakënaqur me popullin, duhet ta shpërndajë popullin dhe të zgjedhë një të ri. Vetëm qytetari i lirë dhe aktiv mund ta sfidojë qeverinë dhe t’i mbajë të përgjegjshëm për premtimet paraelektorale.

- **Mediat e lira dhe të pavarura**, janë një shtyllë e rëndësishme e demokracisë. Kontrolli i mjeteve të informimit pothuajse është sinonim i kontrollit të vendimmarrjes në demokraci. Mediat luajnë rol të rëndësishëm në demokracinë e sotme, çfarëdo që të jetë ai medium-gazetë, televizion, radio, industri e argëtimit dhe natyrisht internet.

Individët, shoqëritë dhe shtetet duhet që të jenë të gatshëm për komunikim me njëri-tjetrin. Që të ndihmojnë vendimmarrjen e elektoratit ata duhet t'i informojnë për qëllimet dhe pikësynimet e atyre që kërkojnë të zgjidhen. Liria e të shprehurit pothuajse është edhe një e drejtë themelore njerëzore për realizimin dhe funksionimin e demokracisë.

Moduli i lirisë së të shprehurit dhe lirisë së mediave.

- **Demokracia dhe të drejtat e njeriut** janë të pandashme- marrëdhënia lëkundet nga bashkëveprimi i njerit tek indentiteti i tjetrit. Në këtë kuptim, të gjitha të drejtat njerëzore kanë rëndësi të veçantë për demokracinë. Sistemi juridik i disa shteteve i dallon të drejtat qytetare prej të drejtave njerëzore, duke nënkuptuar se disa të drejta politike në veçanti u janë garantuar vetëm qytetarëve të tyre, ndërsa të tjerat të gjitha qenieve njerëzore. Të drejtat njerëzore mund të garantohen vetëm me funksionimin e demokracisë, por demokracia e brishtë nuk garanton të drejtat e njeriut dhe sigurinë njerëzore. Realizimi i të drejtave të njeriut, si pasojë, është një indikator i vitalitetit të demokracisë.

#### **4. ZBATIMI DHE MONITORIMI**

Nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston asnjë demokraci e përsosur. Të gjitha demokracitë moderne përbëhen, deri në një shkallë, nga elementet thelbësore të demokracisë në jetën publike të tyre, si një masë e barazisë, mosdiskriminimit dhe e drejtësisë sociale. Demokracia është një proces i bashkëveprimit konstant, i përfeksionimit dhe përshtatjeve ndërmjet nevojave themelore të shoqërisë dhe strukturave sociale për t'i plotësuar këto nevoja.

Në shkallë rajonale, ekzistojnë mekanizma të ndryshme të parimit të mbrojtjes së demokracisë. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ofron mundësi për paditje ndaj shteteve të cilat shkelin konventën, është një shembull i mirë brenda sistemit. Më 1967 Danimarka, Norvegjia dhe Suedia morën vendimin që të ankohen kundër Greqisë pasi që një regjim i ashpër ushtarak mori kontrollin atje. Qeveria greke menjëherë hoqi dorë nga konventa, por pa marrë parasysh këtë fakt, gjykimi u mbajt dhe përfundoi me suspendimin e Greqisë nga Këshilli i Evropës. Me rithemelimin e qeverisë demokratike në vitin 1974, Konventa hyri në fuqi përsëri, dhe u desh të kompensohen viktimat e regjimit ushtarak.

Me sa duket, të gjithë mekanizmat nuk janë efektive siç është vendosur nga Këshilli i Evropës, por po ashtu ka organizata të ndryshme që luftojnë për mbrojtjen e demokracisë. Në vitin 1990, OSBE themeloi Zyrën për Institute Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ZIDDN) në Varshavë, e cila kishte për detyrë që, përveç të tjerash të ndihmojë shtetet pjesëmarrëse të OSBE për ndërtimin, forcimin dhe mbrojtjen e institucioneve demokratike. Kjo zyrë është në krye të monitorimit të zgjedhjeve nacionale, në mënyrë që të sigurojë bindjen në parimet demokratike.

Në nivel ndërkombëtar, Unioni Ndërparlamentar (UNP) luan një rol të rëndësishëm. UNP përbëhet nga parlamentet e shteteve sovraane dhe kërkon që të kujdeset për dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet njerëzve, për forcimin e demokracisë në të gjithë botën. Ajo u themelua në vitin 1889 dhe deri më tani është një organizatë që ndihmon ndërlidhjen e parlamenteve nacionale dhe nxit demokracinë.

Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (PZHKB- UNDP) ka prezantuar në raportin e tij për zhvillim njerëzor të vitit 2002, një numër të indikatorëve objektivë për matjen e përparimit të demokracisë. Këtu përshihen:

- Data e zgjedhjeve të fundit
- Pjesëmarrja e votuesve
- Numri i femrave për vit, të cilat kanë fituar të drejtën për votë

- Numri i ulëseve në parlament që mbahet nga femrat
- Anëtarësimi në sindikata
- Organizatat joqeveritare
- Ratifikimii i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike
- Ratifikimi i Konventës së ONP të Shoqërimit dhe Mbledhjes Kolektive

Si shtesë, një numër i indikatorëve subjektiv, përfshirë edhe liritë civile dhe të drejtat politike, liria e shtypit dhe përgjegjësia, stabiliteti politik dhe mungesa e dhunës, sundimi i ligjit dhe kutpimi i treguesve të korrupsionit, përbëjnë një mjet ndihmës që të vlerësojnë qeverisjen demokratike. Të gjithë këta indikatorë reflektojnë një nivel në të cilin elementet thelbësore që e formojnë demokracinë bashkëveprojnë dhe zhvillohen njëkohësisht. Ata ofrojnë bazat krahasuese për demokracitë dhe regjimet e tjera dhe vlerësojnë progresin drejt demokracisë, si dhe cilat masa kualitative dhe kuantitative në shkallë të përmirësimit i ka arritur apo me cilat kërcënime përballet vendi.

Në të gjitha demokracitë e vërteta, vota e popullit në nivel nacional apo lokal, është mekanizmi më i fortë monitorues, i përcjellë nga mediat e lira dhe të pavarura dhe një shoqëri civile vigjilente. Ndërrimi në agjendat qeveritare dhe strukturat fuqimbajtëse mund të rezultojnë ashtu që një votë e tillë popullore, e cila kontrollon në mënyrë të pavarur shkallën e zbatimit të zotimeve të ndërmarra nga përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike.

Standardet e demokracisë që duhen të përmbushen nuk janë të dakorduara në mënyrë universale. Megjithatë, standardet mbi të cilat një koncenzus i gjerë mund të arrihet janë ato të të drejtave të njeriut. Sigurimi i të drejtave të njeriut është një pjesë qenësore e sigurimit të demokracisë. Prandaj, garantorët institucional të të drejtave të njeriut janë me të vërtetë garantuesit e demokracisë.

Zbatimi botërore i demokracisë varet nga çdo individ, në shtet dhe institucione ndërkombëtare i duhur që të vërë jetën në të dhe të ndihmojë t'i përballojë zhvillimet autoritare. Me rëndësi të veçantë është të përfitohet nga e drejta për votë, shprehja e

opinionëve dhe kështu të merr pjesë në jetën politike dhe vendimmarrje. Pjesëmarrja në një shoqëri civile aktive është ndihmë për demokracinë si tërësi. Arsimimi luan një rol kyç në këtë proces dhe krijon edhe dijen që e bën të mundshme pjesëmarrjen efektive në rend të parë. Këto janë elementet themelore të ndërtimit të demokracisë ku duhet të përqendrohet vëmendja dhe duhet të ketë zhvillime të mëtutjeshme në mënyrë që të lejojë demokracinë që të lulëzojë dhe t'i vjelë rezultatet për të gjithë në mënyrë të barabartë dhe paanshëm.

## **E DOBISHME TË DIHET**

### **1. PRAKTIKA TË MIRA**

#### **Në rrugën për demokraci**

Në shkurt të vitit 1990 në një fjalim historik Frederik Uilliem de Klerk foli në favor të përfundimit të regjimit të apartheidit dhe për demokraci në Afrikën Jugore. Politika e tij u konfirmua me referendum, ku 70% e popullsisë së bardhë përkrahu reformat e tij. Zgjedhjet e para demokratike në Afrikën Jugore u mbajtën në prill të vitit 1994, kurse në maj të po atij viti Nelson Mandela u bërë presidenti i parë i zi i Afrikës Jugore. Me këtë u hap një kapitull i ri i zhvillimit të vendit.

#### **Evropa Qendrore dhe Lindore, Azia Qendrore:**

Që nga viti 1989 vendet e bllokut komunist përjetuan një valë të demokratizimit. Parti të reja demokratike u krijuan në Poloni, Bullgari, si dhe dhe në Republikën Çeke, Gjermaninë Lindore, Hungari, Rumani, Sllovaki dhe një numër të ish-republikave të Bashkimit Sovjetik, dhe në paqe, tranzicioni demokratik filloi të ndryshojë tabloun e politikave nacionale. Pas kësaj, zgjedhjet demokratike parlamentare dhe presidenciale filluan në intervale të rregullta, mbi baza të sistemit shumëpartiak.

**Kili:** Ndryshe nga vendet e Amerikës jugore, Kili ka një histori 150 vjeçare të republikës kushtetuese me një qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike. Rivendosija e demokracisë në Kil në vitin 1990, pas 17 vjetësh të sundimit ushtarak nën gjeneralin Augusto Pinoçe, i dha një nxitje të re dialogut demokratik dhe kooperimit rajonal dhe ndërkombëtar. Sot

Republika e Kilit është një demokraci e konsoliduar dhe në mënyrë aktive ajo promovon të drejtat e njeriut dhe sigurinë njerëzore në të gjithë rajonin.

Diktatura e Ferdinand Markosit në Filipine zgjati nga viti 1965 deri më 1986. Në vitin 1986 Korazon Aquino u bë presidente dhe ktheu liritë civile themelore (lirinë e të shprehurit, lirinë e shoqërimit dhe lirinë e shtypit) – Filipinet iu kthyen rrugës për stabilizimin e demokracisë së vërtetë.

## **2. TRENDET**

### **Pjesëmarrja politike e femrave**

Sot, pjesëmarrja e femrave në jetën politike është shumë joproporcionale me atë të meshkujve, edhe pse femrat përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë së botës. Ky debalanc i dukshëm vë në pah mungesa të veçanta në një numër të insitucioneve nacionale që konsiderohen si demokratike.

Hyrja në kuotat për nxitje dhe mbështetje të pjesëmarrjes së femrës në jetën politike është përdorur si vegël për përmirësimin e situatës, e cila është konsideruar me përfaqësim joproporcional dhe status të pabarabartë të burrave dhe të grave në parlamentet nacionale. Deri më tani, 10 vende në botë kanë arritur përfaqësimin e femrave në parlament deri në 30 %, shumica me mjete të futjes së kuotave (përqindjeve fikse që të sigurojnë praninë e femrave në parlament dhe në legjislaturë). Nëse përmirësimi vazhdon sipas kursit të tanishëm, mund të marrë më shumë se 50 vite për të arritur një përfaqësim të plotë proporcional të femrave.

*Diskuto çështjen: a mund të mendoni për ndonjë stimulim dhe vegla të tjetra për ngushtimin e hapësirës ndërmjet meshkujve dhe femrave në jetën politike?*

### **Femrat në parlament: 1945 – 1995**

Në 50 vjet, nga vitit 1945 deri më 1995:

- Numri i shteteve sovraane të cilat kishin parlament u rrit për shtatë herë
- Përqindja e femrave si anëtare të parlamentit u rrit për katër herë

- Rekordi në shkallë të përgjithshme u arrit në vitin 1988 me 14,8% femra nga numri i përgjithshëm i të gjithë anëtarëve të parlamentit në botë.

Moduli i të Drejtave të Njeriut

### Demokr@cia Drejtpërdrejt (Online)

Kur përdorimi i internetit filloi të përhapej në mesin e viteve '90, te disa u rritën ëndrrat e një bote më të mirë– për një botë ku të gjithë mund të marrin pjesë në procesin politik të vendimmarrjes, falë komunikimit të drejtpërdrejt, për një botë më afër idealeve greke të demokracisë, më shumë se asnjëherë. Për të përmbledhur, këto ëndrra ende nuk janë bërë realitet. Në të vërtetë, është shumë e dyshimtë nëse do të bëhen ndonjëherë.

Viti	1945	1955	1965	1975	1985	1995
Numri i parlamenteve	26	61	94	115	136	176
% e femrave në Parlament	3.0	7.5	8.1	10.9	12.0	11.6
% e femrave si senatore	2.2	7.7	9.3	10.5	12.7	9.4

#### **BURIMI:**

UNIONI NDËRPARLAMENTAR, [WWW.IPU.ORG](http://WWW.IPU.ORG), 2003

	Dhomë njëjës Ose e ulët	dhoma e lartë ose senat	të dy dhomat kombinim
Vendet nordike	39.7 %	--	39.7%

Shtetet anëtare të OSBE të Evropës përfshirë edhe Vendet nordike	18.1 %	14.8%	17.4%
Amerikanët	16.2%	18.4%	16.5%
Shtetet anëtare të OSBE të Evropës, pa vendet nordike	15.7%	14.8%	15.5%
Azia	15.4 %	13.0%	15.3%
Afrika nën Saharë	13.7%	12.7%	13.6%
Paqësori	13.7%	25.9%	15.2%
Shtetet Arabe	6.1%	2.6%	5.7%

**BURIMI:**

WWW.IPU.ORG, SIPAS 23 DHJETORIT 2002.

Disponueshmëria e qasjes në internet nuk është surrogat për strukturat demokratike dhe si e tillë nuk krijon vetëdijësim politik, por prapëseprapë ka disa përparësi. Informata mund të hulumtohet dhe rigjendet në të gjithë botën në kohë reale, dhe çka është më me rëndësi,

mund të ndërrohet dhe përdoret për krijimin e strukturave organizative joformale. Kjo ka ndodhur shumë shpesh në vitet e fundit.

Aktivitetet e OJQ-ve anembanë botës janë rritur në mënyrë të shpejtë falë komunikimit të drejtpërdrejtë, duke themeluar lidhje në mes të lëvizjeve në të gjitha pjesët e botës. Fushatat mund të mbledhin njerëz më shumë se kurrë më parë, duke mobilizuar forma të reja të kooperimit të orientuar për çështje përtej kufijve. Regjimet totalitare nuk kanë apo nuk kanë fare mjete të kufizuara për ta ndaluar shkëmbimin e ideve “revolucionare” në mënyrë të drejtpërdrejtë. Individët mund të shprehin opinionin e tyre më lehtë dhe ta bëjnë të njohur botërisht, duke gjetur përkrahje nga njerëzit me mendime të njëjta.

No kohën e tashme, afërsisht 400 milion njerëz anembanë botës përdorin internetin, kurse 5.8 miliardë ende jo. E ashtuquajtura ndarje digjitale në mes të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim (si dhe në mes vendeve urbane dhe atyre rurale përbrenda vendeve të zhvilluara) ka një ndikim serioz në modelin e demokracisë – nëse shumica e popullatës janë analfabetë të kompjuterit, nuk mund të marrin pjesë në aktivitetet online (të drejtpërdrejta).

Sfidat demokratike nuk janë vetëm për sigurimin e qasjes, por edhe për përmbajtjen. Për shembull, Ku Klux-Klani ultraracist në SHBA pohon se ç’prej se ka një prezencë të drejtpërdrejtë (online), numri i anëtarëve të tij është rritur konsiderueshëm, dhe kështu niveli i organizimit vazhdon të rritet. Në Francë dritarja e internetit “Yahoo!” është paditur për ofrimin e shenjave përkujtuese të neonacizmit në faqen e tyre të ankandeve – por ofertat ishin bërë në SHBA, dhe atje një sjellje e tillë nuk është ilegale. Ndërkohë, “Yahoo!” ka deklaruar në baza vullnetare që të monitorojë dhe të ndalojë aktivitetet e tilla.

Demokracia është një proces kompleks, dhe në mënyrë që të funksionojë si duhet, i nevojitet zotimi ynë i plotë. Interneti mund të jetë një medium që e lehtëson komunikimin, por kurrë nuk do të jetë zëvendësues për mungesën e angazhimit në botën ofline (të pakëz drejtpërdrejt në internet).

Moduli i lirisë së të shprehurit dhe lirisë së mediave

### **Globalizmi dhe demokracia**

Tradicionalisht, pjesëmarrja politike ka linjën e saj ndarëse në kufijtë nacionalë, vendimet që ndikojnë në jetët e njerëzve bëhen në bazë të territoreve specifike.

Në kohën e globalizimit shumë vendime dhe rezultatet e tyre shtrihen përtej kufijve kombëtar. Veç kësaj, faktorët e mëdhenj global, siç janë kompanitë multinacionale dhe organizatat ndërkombëtare janë të përgjegjshme për ndërrimet e arritura socio-ekonomike në botën tonë. Globalizimi po ashtu mund të ndihmojë për shpërndarjen e demokracisë, duke i bërë më të arritshme për të tjerrët teknologjitë e reja dhe informatat.

Pakujdesia e demokracisë në këtë botë të globalizuar, ku vendimmarrja shpesh është në duart e forcave ekonomike apo instituteve të fuqishme, është përgjigje e një grupi më të madh ndërkombëtar të lëvizjeve sociale të kohëve tona- lëvizja antiglobaliste. Adhuresit e antiglobalizimit protestojnë për një numër qëllimesh, përfshirë këtu mbrojtjen e ambientit, faljen e borxheve, të drejtat e kafshëve, mbrojtjen e fëmijëve, antikapitalizmin, paqen dhe të drejtat e njeriut. E përbashkëta e tyre është ndjenja se botës së globalizuar i mungon iniciativa demokratike.

Mënyra themelore e kësaj lëvizjeje është demonstrimi masiv. Së pari u vërejt nga mediat ndërkombëtare në vitin 1999, kur 100.000 demonstrues marshuan në ceremoninë e hapjes së takimit të tretë të ministrave në Qendrën Botërore Tregtare (QBT) në Sietell. Pastaj, protesta të tjera u shfaqën në takimin e Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Uashington dhe Pragë, Forumi Botëror Ekonomik në Davos (Zvicër), Samiti u Bashkimit Evropian në Gotheburg (Suedi) dhe Samiti e G-8 në Gjenovë (Itali).

Përderisa shumica e protestuesve nuk janë të dhunshëm, është një pjesë e protestuesve radikalë, të cilët në mënyrë aktive provokojnë dhunën në demonstrata, duke gjuajtur gjësende apo duke shkatërruar pasuri. Ata e devijojnë qëllimin e protestave, sepse e

tërheqin pjesën më të madhe të mediave drejt tyre, gjë për të cilën shumica mendojnë që është fatkeqësi.

Prandaj, në shkurt të vitit 2002, disa aktivistë organizuan mbledhjen në Forumin Social Botëror në Porto Alegre në Brazil, si një alternativë të demonstratave masive shpërthyes. 60.000 pjesëmarrësit si përfundim diskutuan alternativat e kapitalizmit global, opozitën ndaj militarizmit dhe mbështetjen për paqe dhe drejtësi sociale.

Duke ushtruar të drejtën e tyre për t'u mbledhur, shoqëria civile ka provokuar një debat publik mbi qeverisjen demokratike globale, mbi demokratizimin e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në institucionet ndërkombëtare. Lëvizja thërret për vëmendje ndaj rrezikut konstant që liberalizmi ekonomik mund të minojë themelet e tij, me liritë civile dhe politike, duke u tallur me rëndësinë e të drejtave ekonomike dhe sociale.

Megjithëse ndryshimet e pamjes në të cilën vendimmarrja ndërkombëtare bëhet edhe një valë e re e pjesëmarrjes duket se është një ëndërr e pazakontë, aktorët (e rinj) global në mënyrë të shtuar duhet të japin llogari se çka janë duke bërë në saje të përkujdesjes së rritur publike dhe po ashtu janë të detyruar të mendojnë për mënyra të reja të përfaqësimit demokratik, transparencës dhe përgjegjësisë.

Moduli i lirisë nga varfëria dhe moduli i punës.

### **Deficiti demokratik në organizatat ndërkombëtare, korporatat multinacionale dhe organizatat joqeveritare**

Roli i shteteve në nivelin rajonal dhe global po ndryshon. Organizatat ndërkombëtare, korporatat multinacionale dhe organizatat joqeveritare kanë hyrë në skenë si aktorë të rëndësishëm në politikën botërore. Vendimet dhe rregullat e tyre ndikojnë në politikat e shteteve dhe në jetët e miliona njerëzve. Prandaj, një pyetje kyçe të cilës duhet t'i përgjigjemi është: Sa janë demokratikë/jodemokratikë këta aktorë joshtetërorë? T'i gjesh përgjigjen kësaj pyetjeje do të thotë të hulumtosh veprimet dhe politikat, si dhe procesin e vendimmarrjes të çdo organizate, KMN apo OJQ dhe gjurmimi nëse parimet e

demokracisë (përgjegjshmëria, legjitimiteti, pjesëmarrja, përfaqësimi dhe transparenca) janë përmbushur. Projekt-propozimet për demokratizimin e aktorëve joshtetërorë janë diskutuar gjerësisht. Shmbujt përfshijnë: reformën e Këshillit të Sigurimit; krijimin e Asamblesë Globale të Popujve, si dhe më shumë sisteme demokratike dhe efektive për OTB, FMN dhe Bankën Botërore; themelimi i një parlamenti për OTB; futjen e Kodeve të Sjelljes dhe Kodeve të Etikës për OJQ dhe KMN.

## **AKTIVITETE TË ZGJEDHURA**

### **AKTIVITETI I: FUSHATA**

#### **PJESA I: HYRJA**

Ky është një aktivitet i bazuar në diskutim, që adreson të drejtat dhe përgjegjësitë të ndërlidhura me demokraci dhe debatin demokratik.

**Lloji i aktivitetit:** Diskutim

### **PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI DISKUTIMIN**

#### **Qëllimet dhe pikësynimet:**

- Të praktikohen dhe zhvillohen aftësitë të cilat janë të kërkuara për dëgjim, diskutim dhe bindje
- Të inkurajohet bashkëpunimi dhe puna grupore

**Grupi i synuar:** të rinjtë dhe të rriturit

**Madhësia e grupimit / organizimi shoqëror:** çdonjëri

**Koha:** rreth 60 minuta

**Materialet:** Letër dhe lapsa me ngjyrë, për t'i përgatitur shenjat, shirit ngjitëse, letër dhe lapsa për t'i përgatitur shkrimet.

#### **Përgatitja:**

- Bëji dy shenja “Pajtohem” dhe “Nuk pajtohem” dhe ngjiti ato në një mur të gjatë apo në dysheme.
- Vër dy karrige në qendër të dhomës, dhe lejo hapësirë përreth tyre në mënyrë që njerëzit të lëvizin përreth tyre.

**Aftësitë e përfshira:** Komunikimi, bashkëpunimi, shprehja e mendimeve të ndryshme për një çështje dhe respektimi i opinioneve të tjera.

### **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR DISKUTIMIN**

- Vër të dy shenjat në mur apo në dysHEME dhe shpjego se ju do të lexoni një komunikatë, me të cilën pjesëmarrësit mund të pajtohen në shkallë të gjerë apo të ulët.
- Zgjidhe komunikatën nga lista e mëposhtme dhe lexoje me zë për grupin.
- U thuaj pjesëmarrësve që të pozicionohen afër murit sipas shenjave, nëse pajtohen apo nuk pajtohen.
- Kur pjesëmarrësit të janë pozicionuar, thërrisni dy personat të ekstremeve të kundërta që të ulen në karrige. Çdokush tjetër duhet të mblidhet rreth karrigeve duke u radhitur pas personit me të cilin pajtohen në shkallë të gjerë; apo të rrinë në qendër, kur janë të pavendosur.
- Ua jepni pjesëmarrësve që janë të ulur në karrige një minutë që të deklarohen për arsyet e tyre për pajtimin apo mospajtimin me komunikatën origjinale. Askush nuk duhet t'i ndërpresë ata apo t'u ndihmojë. Çdonjëri duhet të mbajë qetësi.
- Pas komunikatave të tyre, kërko nga të tjerët në grup që të lëvizin pas njëri-tjetrit pas folësve (ata nuk mund të mbeten të pavendosur), pra do të kemi një grup “për” dhe një grup “kundër” komunikatës. Ua jepni të dyja grupeve dhjetë minuta që t'i përgatisin argumentet e tyre për të mbështetur pozicionin e tyre dhe të zgjedhin folësit e veçantë të cilët do të paraqesin argumentet e tyre.
- Ua jepni këtyre folësve të rinj nga 3 minuta që t'i thonë argumentet e tyre. Pas fjalimeve të tyre, përkrahësit për njërin apo tjetrën anë mund t'i ndërrojnë pozitën e tyre dhe të dalin në grupet opozitare në qoftë se argumentet e opozitës i kanë bindur ata.

**Vlerësim:**

E bëni sërish bashkë grupin për vlerësim. Tash vazhdoni të pasqyroni procesin dhe qëllimin e diskutimit si formë, dhe arsyet e respektimit të shoqërisë pluralistë si një vlerë e lartë. Mundohuni që të mos ktheheni mbrapa në diskutim për vetë çështjen.

- A kishte ndonjë që e kishte ndërruar mendimin gjatë bisedës? Nëse po, cilat ishin argumentet që e bindën atë?
- A mendojnë pjesëmarrësit se ndonjë faktor tjetër, përveç argumenteve kishin ndikim tek ata. Shembujt mund të shfaqin presionet, gjuhën emocionale dhe ndjenjat e rivalitetit.
- Për ata të cilat nuk i kanë ndërruar qëndrimet, a kishte ndonjë qëllim pas kësaj dhe brenda ushtrimit? A mund të imagjinojnë ata ndonjë fakt që mund t'i bindë që të ndërrojnë mendimet e tyre?
- Pse njerëzit mbajnë opinione të ndryshme? A është kjo e pranueshme apo duhet të bëhet diç në shoqërinë demokratike?
- A duhet të tolerohen të gjitha opsionet në demokraci?

### **Këshilla metodologjike:**

Pjesa e parë e aktivitetit ku pjesëmarrësit pozicionojnë vetveten nuk duhet të zgjasë më shumë se disa minuta. Ky aktivitet ngrohës ka për qëllim që të themelojë “pozicionin nismëtar” dhe t'i vetëdijësojë pjesëmarrësit se ku qëndrojnë. Synimi i aktivitetit është që të praktikojnë aftësitë e komunikimit dhe të bindjes, duke menduar për qështjet në vetvete. Pjesëmarrësit duhet të inkurajohen që të mendojnëç jo vetëm për përmbajtjen dhe bindjen e mendimeve të tyre, por edhe për llojin dhe formën e argumentit, i cili do të jetë më bindës.

Shënim: Do të shpenzohen rreth 30 minuta që të diskutohet për një formulim i cili duhet të silltet në disa runde të diskutimit. Këshillohet të jetë elastik për renditjen e ngjarjeve, që do të thotë se varet nga grupi. Përgjithësisht, shqetësimet në grup duhet t'i paraprijnë diskutimit.

### **Sygerime për ndryshim**

Ju mund të ngritni çështjen nëse “pluralizmi” apo liria e të shprehurit mund të jetë subjekt i kufizimeve të çfarëdo lloji qofshin ato në shoqërinë demokratike. A duhet të lejohen,

për shembull, protestat nacionaliste apo raciste? Ku dhe si mund ta përkufizojë demokracia linjën në mes të pranueshmërisë dhe papranueshmërisë? Në këtë kontekst, mund të diskutoni nocionin e “tolerancës” dhe mënyrën se si njerëzit e kuptojnë atë.

#### **PJESA IV: VAZHDIMI:**

Zgjidhni fotografi nga gazetatat dhe revistat, të cilat pasqyrojnë çështje kontraverse të lidhura me debatin e tashëm. Mundohuni t’i mbulonit temat si diskriminimi i grupeve të veçanta (fëmijët, femrat, të huajt, grupet religjioze, personat e hendikepuar etj.), ndotjen e ambientit, papunësinë, varfërinë, shtypjen nëpërmjet shtetit, dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në përgjithësi. Preji fotografitë nga revistat dhe tregojua pjesëmarrësve. Lejoni që Lejoni që çdonjëri prej tyre të zgjedhë një fotografi të cilën mund ta tolerojnë dhe një të cilën nuk mund ta tolerojnë. Pjesëmarrësit duhet të tregojnë arsyet se përse e kanë zgjedhur fotografinë e caktuar para së të fillojë diskutimi. Shpjegojua të tjerëve se ata duhet ta respektojnë opinionin e pjesëmarrësve.

#### **BURIMI:**

KJO PJESË ËSHTË MARRË NGA: SUZANË ULRIH. 2000. ACHTUNG (+) TOLERANZ – WEGE DEMOKRATISCHER KONFLIKTLOSUNG. VERLAG BERTLESMANN STIFTUNG.

#### **Të drejtat e ndërlidhura / fusha të tjera të hulumtimit:**

Liria e të shprehurit dhe çdo e drejtë e njeriut.

#### **BURIMI:**

KY DISKUTIMI ËSHTË ADAPTUAR NGA: KOMPAS- DORACAKU MBI ARSIMIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT ME TË RINJ.2002. PUBLIKIME TË KËSHILLIT EVROPIAN: STRASBOURG.

#### **Qëndrimet që mund të përdoren për diskutim:**

- Ne kemi obligim moral që të përdorim votën tonë në zgjedhje
- Ne duhet t’i respektojmë të gjitha ligjet, edhe ato që janë të njëanshme.

- Të vetmit njerëz që kanë pushtet në demokraci janë politikanët
- Njerëzit i zgjedhin udhëheqësit që i meritojnë.
- “Në demokraci çdokush ka të drejtë që të përfaqësohet, edhe budallenjtë.”  
(Kris Paten)
- 51% e popullit mund të përbëjë një regjim totalitar, të shtyp pakicat dhe prapëseprapë të mbetet demokratik.
- “Puna e qytetarit është që ta mbajë gojën e tij të hapur” (Gynter Gras. shkrimtar)
- “Argumenti më i mirë kundër demokracisë është një bisedë pesë minutëshe me një votues mesatar.” (Uinston Çerçil)

Shënim: Ju mund të gjeni edhe thënie të tjera që ndërlidhen me ndonjë të drejtë tjetër njerëzore. Thëniet duhet të jenë të formulura në mënyrë që të provokojnë të shprehurit e opinioneve të ndryshme.

## **2 AKTIVITETI II: Një minare në bashkësinë tonë?**

### **PJESA I. HYRJE**

Ky aktivitet simulon një asamble të hapur këshilluese në bashkësinë tuaj apo në një fshat të vogël të imagjinuar. Në këtë skenë interesant dhe brengat e lëvizjeve të ndryshme sociale dhe politike përplasen në të ashtuquajturat “tema të nxehta. Shtypi e përcjell dhe e dokumenton mbledhjen.

**Lloji i aktivitetit:** Lojë simuluese

### **PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI SIMULIMIN**

#### **Qëllimet dhe synimet:**

- Të përjetohet procesi ku njerëzit/ bashkësia tentojnë të kuptojnë se çka është duke ndodhur
- Të identifikohen dhe të kuptohen mekanizmat dhe përmbajtja politike
- Të elaborohet rasti dhe të hidhen pikëpamje të ndryshme

- Të identifkohen kufizimet e sjelljes demokratike dhe të respektueshme
- Të kujdesesh për simpatinë për të gjitha palët në një konflikt

**Grupi i synuar:** të rinjtë dhe të rriturit

**Madhësia e grupimit / organizimi shoqëror:** 15-30

**Koha:** 2-3 orë

**Përgatitja:** Fletë për shënim të emrave, hamerë dhe letra të mëdha

**Aftësitë e përfshira:**

Komunikimi, kooperimi, shprehja e pikëpamjeve të ndryshme për çështjen dhe respektimi i opinionit të të tjerëve.

### **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE MBI SIMULIMIN**

**Hyrje në temë:**

Fillo të prezantosh aktivitetin dhe të shpjegosh për një situatë të imagjinuar, dhe për një grup i cili merr pjesë në këtë situatë.

Ndërtimi i një minareje po e lëkund bashkësinë tuaj. Me një njoftim të shkurtër, këshilli i bashkisë është thirrur që të vendosë për kërkesën e komunitetit islam që të ndërtojë minarenë në një lartësi e cila do të jetë më e madhe sesa këmbanarja e kishës.

Radhitni në hamerë rolet e ndryshme që do t'ua shpërndani pjesëmarrësve. Njerëzit që do të marrin pjesë në këshill janë:

- Kryebashkiaku, si kryesues i asamblesë
- Anëtarët e këshillit të qytetit (3-5 persona) që përfaqësojnë palë të ndryshme
- Anëtarët e grupit punës “për një botë- kundër ksenofobisë” (3-6 persona)
- Anëtarët e komisionit veprues të qytetarëve “mirëseerdhët në bashkësinë tonë të dashur!” (3-5 persona)
- Anëtarët e bashkësisë islame (3-5 persona)
- Shtypi: gazetarët e dy gazetave lokale të cilat i kundërshtojnë qasjet politike (1-2 persona për çdonjërin)

- Qytetarët, të cilët do të marrin pjesë në asamble (nëse ka pjesëmarrës të mjaftueshëm)

A keni parasysh se, sa më mirë t'i përshkruani karakteret e ndryshme, aq më efektiv do të jetë simulimi. Nëse dëshironi, ju mund t'i shkruani disa karakteristika të njerëzve të ndryshëm në hamer. Tento të themelosh një mori rolesh që përmbajnë llojllojshmëri të karaktereve të ndryshme, në mënyrë që të simulosh një diskutim më të mirë.

Skico orarin: para se të fillojë simulimi, pjesëmarrësit duhet të zhvillojnë karakterin e ri dhe duhet t'i shkruajnë fjalët kryesore ( rreth 15 minuta). Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'u përmbahen me rigorozitet roleve të tyre dhe të zvogëlojnë pozicionin e tyre personal.

### **Simulimi:**

Futja e elementeve për afërsisht në shumën që përputhet me kohën e kërkuar.

### **Faza 1: Përgatitja (20 minuta)**

Kërkoni nga pjesëmarrësit që të bëhen bashkë në grupet që i kanë zgjedhur. Nëse është e mundur, atyre do të ishte mirë që t'ua lini klasët e tyre dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme. Karakteret duhet të njihen me njëri-tjetrin dhe të vendosin për strategjinë e tyre për këshillin e hapur. Shtypi duhet të fillojë editimin e gazetës së tyre të parë dhe marrjen e intervistave të para. Gjatë kësaj faze, ju duhet ta përgatitni dhomën e konferencave për takim. Grupet duhet të jenë të ulura në katër tavolina të ndryshme. Tabelat me emra duhet të vihen në çdo tavolinë. Kryebashkiaku duhet të ulet në një pozitë më të lartë dhe duhet të ketë një zile dhe të shikojë në tavolinën e tij/saj. Ia shpjego ndaras rregullat e procedurës personit që do të aktrojë kryebashkiakun gjatë kohës së takimit.

### **Faza 2: Takimi i hapur i Këshillit (45 minuta)**

Kryebashkiaku është drejtues i asamblesë dhe ai e hap takimin me një fjalim të shkurtër. Hap çështjen dhe i përshëndet pjesëmarrësit. Detyra e tij/saj kryesore është që të moderojë takimin. Grupeve njërit pas tjetrit u kërkohet t'i japin opinionet dhe qëllimet e

tyre. Karakteret, rolet e përgatitura për ta duhet të jenë udhëzimet për veprime të tyre. pastaj, kryebashkiaku thërret votuesit që të vendosin se a do t'i jepet leja bashkësisë islame për ndërtimin e minaresë së plotë.

### **Faza 3: Vlerësim (45 minuta)**

Mblidh pjesëmarrësit përsëri në rrethin i cili mundëson diskutimin dhe fillo rundin e vlerësimit, duke i përshëndetur të gjithë me emrat e vërtetë. Kjo është me rëndësi të veçantë që t'i lejojë pjesëmarrësit të dalin nga rolet që i luajtën dhe t'i ktheni prapë në sjelljen e tyre normale.

Në nivel personal pyetini pjesëmarrësit

- A reflektohet rezultati i simulimit në qëllimin e rolit tuaj?
- Sa influencë keni pasur (në rolin tuaj) mbi rezultatin?
- Ndërveprimi me të tjerët, a kërkon ndryshimin e strategjisë suaj?

Mundohuni t'i shmangeni ndjekjes së simulimit edhe te qëndrimi i reflektimit të vetvetes.

Analizo simulimin në krahasim me këshillin e hapur të jetës së përditshme, pyet:

- Çka ishte e vështirë që të identifikohet në rolin tuaj?
- Sa afër ishte simulimin me situatën reale?

### **Këshilla metodologjike:**

Nëse është e mundur duhet ta bëni këtë aktivitet bashkë me një trajner tjetër në mënyrë që të bëni të mundshëm pyetjen dhe të koordinoni çdo hap të aktivitetit në kohë të njëjtë. Kur i ngarkoni rolet, mbani mend se roli i kryebashkiakut është shumë i nevojshëm si strukturues i kahut të simulimit. Ju duhet të ushtroni simulimin e kryebashkiakut me pjesëmarrësin që e luan këtë rol, para simulimit përfundimtar. Mbani mend se ju jeni udhëheqësi i aktivitetit dhe ndoshta do të ishte e nevojshme që të ndërhyni në kahjen e simulimit, në qoftë se pjesëmarrësit fillojnë të mos e respektojnë njëri-tjetrin. Po ashtu, ndërhyj kur simulimi del jashtë kontrollit (zbulimi i fakteve të reja, ndërrimi i temës etj).

Nëse këshilli i hapur nuk arrin marrëveshje, thekso se kjo mund të reflektohet në jetësn e përditshme dhe do të thotë se aktiviteti ka dështuar.

### **Sygjerime për ndryshim**

Në bazë të përbërjes së bashkësisë, ju duhet ta ndërroni temën si “Kisha në bashkësinë tonë” apo “ Tempulli budist në bashkësinë tonë në vend të minaresë.

### **PJESA IV: VAZHDIMI:**

Nëse është e mundur personi që luan rolin e “shtypit” në simulim, të mund të incizojë apo të xhirojë takimin e këshillit të hapur dhe të përdorë këtë dokumentim si bazë për një analizë të diskutimit dhe të rregullave të tij një ditë më vonë.

Në qasje të temës për demokracinë lokale në ambiente të ndryshme, pjesëmarrësit duhet të shikojnë në rrethinat e tyre, të gjejnë një rast real të jetës dhe të dokumentojnë atë. Rezultatet e tyre mund të shënohen në një plan apo një ekspozitë të vogël.

### **Të drejtat e ndërlidhura / fusha të tjera të hulumtimit:**

Diskriminimi, liritë e religjionit, liria e të shprehurit dhe liritë e mediave

### **BURIMI:**

KJO PJESË ËSHTË MARRË NGA: SUZANË ULRIH.2000. ACHTUNG (+) TOLERANZ – WEGE DEMOKRATISCHER KONFLIKTLOSUNG. VERLAG BERTLESMANN STIFTUG.

### **BIBLIOGRAFIA**

**Kofi Anan. 2002.** Ne Njerëzit. Roli i Kombeve të Bashkuara në shekullin 21. New York: Kombet e Bashkuara, në dispozicion online në adresën:

<http://www.un.org.millenium/sg/report/>

**Projekti i Koalicionit Demokratik:**

<http://www.democoalition.org/html/home.html>

**Xhonoathan Foks. 1999.** Tabloja e inspektimeve të Bankës Botërore: A do të rritë përgjegjësinë e bankës? Santa Kruz: Universiteti i Kalifornisë: në dispozicion online në:

<http://www.hypatia.ss.uci.edu/brysk/foz.html>

**IDEA International:** [www.idea.int](http://www.idea.int)

Unioni Ndërparlamentar: [www.ipu.org](http://www.ipu.org)

UNDP. 2002. Raporti i Zhvillimit Njerëzor. Oksford: Shtypi Universitar i Oksfordit.

**INFORMATA PLOTËSUESE:**

**Beetham David dhe Kevin Boyle. 1995.** Duke Paraqitur Demokracinë: 80 pyetje dhe përgjigje. Kembrixh: Polity press.

**Inoguchi Takashi, Newman Edward, Keane John. 1998.** Karakteri ndryshues i demokracisë. Shtetet e Bashkuara: Shtypi i Universitetit të Kombeve të Bashkuara.

**David Held. 1995.** Demokracia dhe rendi global: Nga shteti modern deri te qeverisja kosmopolite. Oksford: Polity Press.

**Robert O. Keohane, Nye S. Joseph. 2001.** Qeverisja Globale dhe Përgjegjësia Demokratike. Dokument. Durham: Universiteti Duke. Në dispozicion online në:

<http://www.poli.duke.edu/people/Faculty/docs/millpaper.pdf>

**Hetty Kovach, Neligan Caroline, Benall Simon. 2003.** Raporti i Përgjegjësisë Globale 2003: Fuqia pa përgjegjësi?. Londër: One World Trust. në dispozicion online nën :

[http://www.wto.org/english/news\\_e/news03\\_e/gar2003\\_e.pdf](http://www.wto.org/english/news_e/news03_e/gar2003_e.pdf)

**Deepak Nayyar, Court Julius. 2002. Drejtimi i Globalizimit: Çështjet dhe Institucionet.** Helsinki: UNU/WIDER.

**Joseph S Nye. 2001. Deficiti Demokratik i Globalizimit: Si t'i bëjmë Institutet ndërkombëtare më të përgjegjshme.** Foreign Affairs (Vëllimi 80, Edicioni 4). New York: Këshilli mbi çështjet e jashtme.

**Toni Porter. 2001. Deficiti demokratik në marrëveshjet institucionale për rregullimin e financave globale.** Qeverisja Globale: Rishikim i multilaterizmit (Vëllimi 7, Edicioni 4, 2001). Kaliforni: Lynne Reinner Publishers, ACUNS+UNU.

**Helmut Reinalter. 2002. Die Zukunft der Demokratie.** Innsbruk: Studien Verlag.

**Rezoluta themeluese e tablosë inspektuese:** Rezoluta Nr. IBRD 93-10 + Rezoluta Nr. IDA 93-6

**Aart Jan Scholte. 2002. Shoqëria Civile dhe Demokracia në Qeverisjen Globale.** Qeverisja Globale: Rishikim i multilaterizmit (Vëllimi 8, Edicioni 3, 2001). Kaliforni: Lynne Reinner Publishers, ACUNS+UNU.

**UNDP. 2002. Raporti i zhvillimit njerëzor 2002: Thellimi i demokracisë në një botë të ndarë.** Nju Jork: Oksford: Polity Press. Në dispozicion përmes faqes së internetit:

<http://www.hdr.undp.org/reports/global/2002/en/>

**Uiçard Uojke. 2000. Handörterbuch Internationale Politik.** Opladen: Leske + Budrich.

**Qendra Informuese Bankare:** [www.bicusa.org](http://www.bicusa.org)

**Karta 99.** [www.charter99.org](http://www.charter99.org)

**Punët e jashtme në fokus. [www.foreignpolicy-infocus.org](http://www.foreignpolicy-infocus.org)**

**Tabloja Inspektuese e Bankës Botërore:**

**[www.inspectionpanel.org](http://www.inspectionpanel.org)**

**One World Trust: [www.oneworldtrust.org](http://www.oneworldtrust.org)**

**Fondacioni për shoqëri të hapur: [www.soros.org](http://www.soros.org)**

**Kombet e Bashkuara: [www.un.org](http://www.un.org)**

**Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim:**

**[www.undp.org](http://www.undp.org)**

**Banka Botërore: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)**

**Organizata Botërore e Tregëtisë: [www.wto.org](http://www.wto.org)**